



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 243

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E GAZETARËVE DHE OPERATORËVE TË QENDRËS SHQIPTARE PËR GAZETARI CILËSORE, GAZETA TEMA, SHOQËRIA DOSJA SH.P.K, FAX MEDIA NEWS, TV KLAN, RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR, GAZETA "KOHA JONË", ANTENA TELEVISION PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021.

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore", pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Qendrës Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ) për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Gazetës Tema për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë Dosja shpk për akreditimin e 14 (katërmbëdhjetë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.



4. Të miratojë kërkesën e Televizionit “Fax Media News” për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Të miratojë kërkesën e Televizionit “Klan” për akreditimin e 25 (njëzet e pesë) gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 5, bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Të miratojë kërkesën e Radio Televizionit Shqiptar për akreditimin e 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 6, bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Të miratojë kërkesën e Gazetës “Koha Jonë” për akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 7, bashkëlidhur këtij vendimi.
8. Të miratojë kërkesën e Antena Televizion për akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 8, bashkëlidhur këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

